




REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dostezuar Primljeno / Prodato Received / Delivered	24.03.2023	3	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKNISHOKA	2980/2023		1/4



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOS

A.nr.132/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtare, me Sabile Avdyli - Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, në lidhje me ankesën A.nr.132/2023 të datës 24.01.2023 të parashtruar nga ankuesi

kundër organit të punësimit Presidencë e Kosovës, në çështjen juridike "Kërkesë nga Marrëdhënia e Punës", duke vepruar në pajtim me nenin 16 paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 24.03.2023, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.132/2023 e datës 24.01.2023 e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi \_\_\_\_\_ i punësuar sipas Akt emërimit të datës 01.07.2019 në pozitën Administrator i Lartë i TI-së për Sisteme në Zyrën e Presidentes se Republikës së Kosovës më datë 24.01.2020 me vendimin me nr.03/20 caktohet ushtrues detyre Menaxher i TI. Me datën 30.11.2022 Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm të Zyrës së Presidencës, ka nxjerr Vendimin Nr.192/2022, sipas së cilit nëpunësin B.B. cakton Ushtrues Detyre i Udhëheqësit të Teknologjisë Informativë në Zyrën e Presidencës.

I pakënaqur me Vendimin Nr.192/2022 të datës 30.11.2022, me datën 24.01.2023 ka parashtruar ankesën me numër protokollit 732/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore për shkak të shkeljeve të dispozitave të Legjislacionit të Shërbimit Civil si dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 02.02.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit te organi i punësimit, ndërsa ky i fundit më datë 14.02.2023, ka dërguar përgjigje në ankesë së bashku me shkresat e lëndës.

**Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave ka administruar këto prova:** Ankesën me numër protokolli 732/2023 të datës 24.01.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Akt Emërimi i datës 01.07.2019; Vendim me numër 85 të datës 27.01.2020; Vendim me numër 02/011-1485-01/22 të datës 30.11.2022; Diplomë me numër 453/14 të datës 23.03.2015; Certifikatë të datës 05.04.2009; Certifikatë të datës 25.01.2010; Certifikatë të datës 25.01.2010; Certifikatë të datës 28.04.2010; Certifikatë të datës 28.04.2010; Formulari për Vlerësimin e Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike për Kategorinë Drejtues i Mesëm, i Ulët dhe Profesional; Konkurs me numër reference RN00010590 të datës 13.12.2022; E-mail zyrtar i datës 23.03.2023 bashkë me provat e bashkangjitura ; Shtojca e Rregullores së Presidencës; Kontratë për shërbime të veçanta e datë 01.03.2018; Kontratë për shërbime të veçanta e datë 30.04.2018; Kontratë për shërbime të veçanta e datë 28.06.2018; E-mail zyrtar i datës 28.06.2018; Kontratë për shërbime të veçanta e datës 31.08.2017; Kontratë për shërbime të veçanta e datë 01.07.2019; Kontratë për shërbime të veçanta e datës 31.07.2019; Kontratë për shërbime të veçanta e datës 26.12.2018 dhe Kontratë për shërbime të veçanta e datës 30.04.2018.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke i shqyrtuar të gjitha provat e lëndës ka konstatuar që ankesa e ankuesit, është e palejuar, sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka analizuar dispozitat ligjore të shërbimit civil që kanë qenë në fuqi në kohën e caktimit të ankuesit në pozitën nga e cila është larguar tash dhe që është objekt i kësaj ankese dhe bazuar në provat që ndërlidhen me këtë çështje ka konstatuar se ankuesi ishte caktuar ushtrues i detyrës më datë 24.01.2020 bazuar në nenin 30 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 03/ L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës që kishte qenë në fuqi në këtë kohë në të cilën dispozitë shprehimisht ishte paraparë si në vijim: "4. Në rast të mbetjes së një pozite të lirë në shërbimin civil, ushtruesi i detyrës nuk mund të emërohet më gjatë se tre (3) muaj" ndërlidhur me këtë çështje dhe bazuar në shkresat e lëndës është konstatuar se ankuesi këtë pozitë e kishte mbajtur deri më datë 30.11.2022 dhe bazuar në këtë dispozitë të referuar si më lartë kolegji i këshillit nuk ka mundur të vërtetoj me asnjë provë se ankuesit i është cenuar ndonjë e drejtë apo interes i ligjshëm në këtë procese , nga se kjo çështje sa i përket të drejtës në ankesë në rast të cenimit të ndonjë të drejte është e rregulluar në dispozitën e nenit 24 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ku përcaktohet se: "3.Nëpunësi civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil sipas këtij ligji...".

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave sa i përket çështjes që është objekt i kësaj ankese ,në kuptim të përcaktimit të së drejtës për të qenë palë në një procedurë administrative i 'u referua nenit 14 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: "1. Palë në procedurën administrative mund të jetë çdo person fizik, person juridik apo grup personash me

*një interes të përbashkët: 1.1. me kërkesë të të cilit organi publik ka filluar procedura administrative; 1.2. ndaj të cilit ka filluar procedura administrative apo të cilit rezultati i procedurës administrative mund t'i cenohet të drejtat apo interesat juridike.....". Ndërsa me nenin 124 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përcaktohet legjitimimi, shkaqet dhe mjetet juridike administrative, ndërsa paragrafi 1 i këtij neni përcakton që: "1.Pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim.....", kështu që, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave, ka konstatuar se vendimi i kontestuar me ankesë nuk cenon ndonjë të drejtë apo interes të ligjshëm të ankuesit, për faktin se ankuesi mbanë pozitën që kishte sipas Akt emërimit të datës 01.07.2019, duke pasur parasysh dispozitat ligjore që rregullojnë shërbimin civil përkatësisht Ligjin Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë se marrëdhënia e punës krijohet me aktin e nënshkrimit të aktemrimit dhe se çdo cenim i ndonjë të drejte që parashihet në këtë dokument zyrtarë/aktemrim, i jep të drejtë secilit që atakohet në ndonjë formë përmes ndonjë veprimi administrativë që të ndërmer veprimet përkatësisht të përdorë mjetet juridike për të mbrojtur një të drejtë të caktuar që i garantohet me ligj, ndërsa në rastin konkretë kolegji i këshillit nuk ka hasur në ndonjë veprim që cenon interesin juridik nga marrëdhënia e punës që garantohet në përmbajtjen e Akt emërimit të datës 01.07.2019, e mbi këtë bazë edhe për të qenë palë në këtë procedurë mbi bazën e cenimit të ndonjë interesi të ligjshëm përmes veprimit të organit përkatës që është atakuar përmes kësaj ankesë.*

Ndërsa sipas gjykimit të Kolegjit bazuar në shkresat zyrtare të kësaj lënde, konstaton se është obligim ligjor i institucioneve në këtë rast zyrës së sekretarit të presidentes dhe udhëheqëses së burimeve njerëzore në këtë institucion që të respektojnë rekomandimet e këshillit me rastin e monitorimeve qoftë të rregullta qoftë të jashtëzakonshme, por në çdo rast veprimet bazuar në këto rekomandime duhet të jenë në harmoni me Ligjin Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe legjislacionin në fuqi që rregullojnë fushat e caktuara dhe që ndërlidhen me rastin e monitorimeve të institucioneve publike .

Bazuar në at që u tha si më lartë dhe duke iu referuar nenit 129 paragrafit 1 nën paragrafit 1.2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.



KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËSF PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
Lënda, A.nr.132/2023, datë 24/03/2023

Sabile Avdyli

*Sabile Avdyli*

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit, [REDACTED]
- Sekretarit të Përgjithshëm të Zyrës së Presidentes;
- Udhëheqëses së Njesisë të Burimeve Njerëzore në Zyrën e Presidentës ;
- Arkivit të KPMSHCK-së.

